



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.154/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Bujar Muzaqi dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesat e Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, tw paraqitur kundër Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë;09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë;25.01.2025, merr këtë,

#### V E N D I M

Refuzohen si të pabazuar ankesat Anr.154/2025, dhe Anr.155/2025, e datës;23.01.2025, të parashtruara nga Subjekti Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë;09.02.2025.

#### A r s y e t i m

Me datë;23.01.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuar Anr.154/2025 dhe Anr.155/2025, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilat ka pretenduar se më datë 22 Janar 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Istog, ka identifikuar banerat/posterat e kandidatëve për deputet, Besim Mulaj, Lisa Rugovaj dhe Shkemb Manaj nga radhët e Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës, të vendosur në ndërtesë publike në rrugën "Fadil Ferati" në Istog. Me këto veprime kandidatët dhe Subjekti Politik LDK, kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP. Si provë për pretendimet në ankesa, parashtruesi ka bashkangjitur fotografi që dëshmojnë vendosjen e banerave/posterave në kundërshtim me LZP.

Në përgjigjet në ankesë të Subjektit Politik LDK, A.nr.154/2025, thekson se për kandidatet, Besim Mulaj, Lisa Rugovaj dhe Shkemb Manaj sa i përket vendosjes se posterve në rr."Fadil Ferati", ekzistojnë Pëlqimet e përkohshme për shfrytëzimin e hapësirës publike. Po ashtu për ankesën A.nr.155/2025, për kandidatin, Besim Mulaj sa i përket vendosjes se posterit në rrugën "Fadil Ferati", ekziston Pëlqimi i përkohshëm për shfrytëzimin e hapësirës publike.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të

Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.154/2025 dhe A.nr.155/2025, të paraqitura me datë;23.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.154/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

PZAP-PZAP, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat vëren se të njëjta janë të pa bazuara.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë, përkatësisht, Pëlqimet e lëshura nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të Komunës së Istogut, nr.11/351-3131/19, nr.11/351-1913/10, dhe nr.11/351-3142/20, të datës;20.01.2025, mbi shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirave publike, konkretisht shfrytëzimin e hapësirës publike për vendosjen e reklamave në murin e ndërtesës publike në rrugën “Fadil Ferati” në Istog, për vendosjen e posterave, vërteton faktin se posterat e kandidatëve për deputet, Besim Mulaj, Lisa Rugovaj dhe Shkemb Manaj, nga radhët e Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës, kanë marrë me leje nga Drejtoria përkatëse e Komunës së Istogut për vendosjen e posterëve në hapësira publike, dhe mbi këtë bazë paneli vlerëson se veprimet e tyre nuk janë në kundërshtim Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024, të Drejtat dhe Obligimet e Subjekteve Politike gjatë Fushatës Zgjedhore, lidhur me Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesat nga parashtruesi i ankesave nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtat i refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Anr.154/2025, datë;25.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.